



Pranuar / Dorezuar Prijmjeno / Predato Received / Delivety	15.03.2022	viti god year	2
Organ / Pjesa Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBAC	1388/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 86/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.86/2022 të datës 02.02.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson avokat [redacted] me adresë [redacted]

Pnr. Podujevë, kundër organit të punësimit/Komuna e Podujevës, në çështjen juridike "kompensim material/tri paga përcjellëse pas pensionimit", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nenparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nenparagrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 15.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.86/20222 e datës 02.02.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] tani i pensionuar, përmes Postës së Kosovës më datë 02.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit Nr.02-14/02-0040057/21 të datës 19.05.2021 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, për shkak të shkeljeve të Ligjit Nr.03-L-149 për Shërbimin Civil, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Marrëveshjes Kolektive të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.02.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Podujevës. Ndërsa më datë 18.02.2022 Këshilli ka pranuar shkresat provat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.86/2022 të datës 02.02.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës; Vendimin me numër protokolli 02-114/02-00400057/21 të datës 19.05.2021 pagesën për pensionimin e ankuesit [REDACTED] Akt Emërimit të datës 03.01.2015; Autorizimin e datës 14.06.2021 i noterizuar; Kopje e ID-së së ankuesit; përgjigje në ankesë me numër protokolli 849/2022 të datës 18.02.2022, Vendimin me numër protokolli 13-118/02-0036122/21 të datës 05.05.2022 të Menaxherit të Personelit lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit për shkak të pensionimit; Urdhër Pagesën për kompensim të pagesës për pensionim të datës 24.06.2021; Lista e pagave e datës 01.12.2013 deri me datë 31.12.201; emiali i datws

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar shkresat e lëndës, konstatoi se ankesa A.nr.86/2022 e datës 02.02.2022, është parashtruar jashtë afatit ligjor, **sepse:**

Sipas provave të lëndës rrjedhë së ankuesi ka qenë i punësuar në Komunën e Podujevës në pozitën e "Udhëheqësit të Sektorit Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural". Me Vendimin me numër protokolli 13-118/02-0036122/21 të datës 05.05.2022 të Menaxherit të Personelit, ankuesit i është përfunduar marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, ndërsa me Vendimin me numër protokolli 02-114/02-00400057/21 të datës 19.05.2021 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, ankuesit i është njohur e drejta e marrjes së një pagesë në shumën prej një page një mujore në vlerën e pagës së fundit gjithsej në vlerë prej 566.45 euro.

Përkritazi me pranueshmerinë e ankesës, e në kuptim të llogaritjes se afatit ligjor për parashtrimin të ankesës, Këshilli me datë 03.03.2022 përmes emailit zyrtar ka kërkuar dëshmi shtesë nga Komuna e Podujevës lidhur me datën e pranimit të vendimit për pensionim dhe vendimit për pagesë pas pensionimit nga ana e ankuesit, mirëpo një provë të tillë organi i punësimit nuk ka arritur ta ofroj për Këshillin. Ndërlidhur me këtë, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se sipas Urdhër Pagesës me numër të kuponit të ditarit 2021-418547 të datës 24.06.2021 ankuesit i është bërë kompensimi i një pagë pas pensionimit në vlerën prej 566.45 Euro, po ashtu ankuesi përfaqësuesin e tij për përfaqësim në gjykata dhe institucionet të tjera shtetërore e ka autorizuar më datë 14.06.2021, rrjedhimisht bazuar në këto rrethana Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se ankuesi ka qenë në dijeni me kohë për aktet juridike të nxjerra nga Komuna e Podujevës e që kanë të bëjë me përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit respektivisht me kompensimin e mjeteve në llogarinë e tij bankare sipas Vendimit 02-114/02-00400057/21 të datës 19.05.2021 të Kryetarit të Komunës së Podujevës.

Bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik është përcaktuar se: *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimi në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative.* Ndërsa sipas nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, kështu që mbi këtë bazë ligjore, dhe duke marrë parasysh faktin se ankuesi ka realizuar pagesën e një page një mujore me rastin e pensionimit, me datë 24.06.2021 sipas Urdhër Pagesës me numër të kuponit të ditarit 2021-418547, Kolegji konston se ankesa e ankuesit e parashtruar në postë me datë 31.01.2022 është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme.*

Bazuar në rrethanat si me sipër, Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.86/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar Avokatit [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

